

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË ELBASAN



**VENDIM**

**LMBLEDHJES SË PËRGJITHËSHME**  
**(ASAMBLESË) TË AKSIONERËVE TË SHOQËRISË**  
**"UNITED QUARRIES" SH.A.**

Sot ditën e Enjte, në datën 20 Qershor 2002, Asambleja e Aksionerëve të Shoqërisë "United Quarries" Sh.A. e thirrur dhe mbledhur rregullisht, mbasi shqyrtoi pikën e pestë të rendit të ditës:

- Emërimi i administratorëve të Shoqërisë "United Quarries" Sh.p.k.,

**Me unanimitet**

**VENDOSI:**

**"Emëron me cilësinë e administratorëve të Shoqërisë "United Quarries" Sh.p.k. Z. Mark Bouri dhe Z. Sadi Dahdale."**

Ky vendim pasi lexohet dhe shihet i formuluar saktë nënshkruhet në prani të Noterit nga Drejtuesi dhe Sekretari i Asamblesë së Shoqërisë "Elbasan Cement Factory" Sh.A.

Drejtuesi i Asamblesë

Sekretari

NOTERI

**NOTERË**  
**ENKELEJDA MARINAJ**

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE E ELBASAN

Nr. 3082 Rep.

Nr. 712 Kol.



**VENDIM NR. 3**  
**I Mbledhjes se Ortakeve te Shoqerise**  
**“UNITED QUARRIES” Shpk.**

Sot ditën e Premte, në datën 21 Nëntor 2003, Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë “United Quarries” Shpk. e thirrur dhe mbledhur rregullisht, mbasi shqyrtoi piken e tretë të rendit të dities:

Emerimi në detyrën e Administratorit të shoqërisë United Quarries Shpk. të personave të mëposhtem:

- Z. Pierre Semaan, shtetas libanez, lindur në Monrovia-Liberi më 25.03.1963, mbajtes i pasaportes nr. 2081132,
- Z. Joseph Abi Khalil, shtetas libanez, lindur në Naame-Liban, më 05.06.1961, mbajtes i pasaportes nr. 1990884, dhe
- Z. Serj Hreiche, shtetas Libanez, lindur në Bejrut më 26.01.1975, mbajtes i pasaportes nr. 0979823.

**VENDOSI:**

“Te emeroje në detyrën e Administratorit të shoqërisë United Quarries Shpk. personat e mëposhtem:

- Z. Pierre Semaan, shtetas libanez, lindur në Monrovia-Liberi më 25.03.1963, mbajtes i pasaportes nr. 2081132,
- Z. Joseph Abi Khalil, shtetas libanez, lindur në Naame-Liban, më 05.06.1961, mbajtes i pasaportes nr. 1990884, dhe
- Z. Serj Hreiche, shtetas Libanez, lindur në Bejrut më 26.01.1975, mbajtes i pasaportes nr. 0979823.

Dokumentat e leshuara nga Administratoret e shoqërisë United Quarries Shpk. janë të vlefshme vetëm nëse janë firmosur nga dy prej tre Administratoreve të shoqërisë”.

*Sr*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE EL BASHKESISE

Nr. 3082 Rep.

Nr. 712 Kol.



**VENDIM NR. 2**  
**I Mbledhjes se Ortakeve te Shoqerise**  
**"UNITED QUARRIES" Shpk.**

Sot ditën e Premte, në datën 21 Nëntor 2003, Asambleja e Ortakeve të Shoqerisë "United Quarries" Shpk. është thirrur dhe mbledhur rregullisht, mbasi shqyrtoi piken e dytë të rendit të dities:


Miratimi i dorëheqjes së Z. Mark Bouri dhe Z. Sadi Dahdale nga detyra e Administratorit të shoqerisë United Quarries Shpk.

**VENDOSI:**


**"Te miratoje dorëheqjen e Z. Mark Bouri dhe Z. Sadi Dahdale nga detyra e Administratorit të shoqerisë United Quarries Shpk".**

Ky vendim pasi lexohet dhe shihet i formuluar saktë nënshkruhet në prani të Noterit nga Drejtuesi dhe Sekretari i Asamblese së Shoqerisë "United Quarries" Shpk.


Drejtuesi i Asamblese

  
Piret J. Sotani

Sekretari

  
S. G. Hoxha

NOTERI

  
Resma Riza

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 11411 Rep.  
Nr. 072 Kol.

Taksa e Pultit  
u pagua

**PROCES VERBAL**  
**I Mbledhjes se jashtezakoneshme te**  
**Ortakeve te shoqerise**  
**"UNITED QUARRIES" SHPK.**  
**Date 14.09.2006**

Sot ditën e Enjte, në datën 14 të muajit Shtator të vitit 2006 (dymijë e gjashtë), në orën 11.00, në selinë e shoqerisë "United Quarries" Shpk, Ortaket e saj mbajnë këtë mbledhje të jashtezakoneshme sipas lajmërimit të bërë nga Administratori i shoqerisë, me qëllim që të shqyrtohet rendi i ditës si më poshtë:

- 1- Ndryshimi i administratoreve të shoqerisë "United Quarries" Shpk.
- 2- Të ndryshme.

**MOREN PJESE NE MBLEDHJE**

- 1- "Seament Albania" Shpk. zoteruese e 137.600 kuotave që përfaqësojnë 86% të kapitalit themeltar të Shoqerisë, përfaqësuar nga Administratoret Z. Serj Hreich dhe Z. Joseph Abi Khalil;


Mbledhja zgjodhi Z. Serj Hreich me cilesine e drejtuesit të Mbledhjes. Drejtuesi mbasi verifikon dokumentacionin perkates, dhe konstaton se të gjithë ortaket janë njoftuar e kanë marrë dijeni rregullisht, deklarën se Mbledhja e Ortakeve është thirrur rregullisht, dhe ortaket që përfaqësojnë 86 % të pjesëve të kapitalit themeltar të shoqerisë "United Quarries" Shpk janë të pranishëm. Në këto kushte vendimet e marra nga kjo Mbledhje konsiderohen të vlefshme.

Ortaket zgjedhin Z. Joseph Abi Khalil në cilesine e sekretarit të mbledhjes.

Drejtuesi deklarën mbledhjen dhe diskutimet të hapura.

**Pika e I e rendit të ditës:**

- 1- Ndryshimi i administratoreve të shoqerisë "United Quarries" Shpk.

  
Joseph Abi Khalil



Perfaqesuesit e ortakut "Seament Albania" Shpk spjegojne se meqenese administratoret ekzistues te shoqerise "United Quarries" Shpk, zoterinjte Pierre Semaan, Serj Hreich dhe Joseph Abi Khalil, largohen nga detyra e administratoreve, dhe per kete ata propozojne qe ne vend te tyre te emerohen zoterinjte Alexander Bouri, Mark Bouri dhe Charles Bouri.

Mbas diskutimit Mbledhjeja e Ortakeve **me unanimitet** mori vendimin e meposhtem:

\* \* \*

VENDIM

"Miratohet largimi i zoterinjve Pierre Semaan, Serj Hreich dhe Joseph Abi Khalil nga detyra e administratoreve te shoqerise "United Quarries" Sh.p.k. dhe emerohen ne vend te tyre Z. Alexander Bouri, Z. Mark Bouri dhe Z. Charles Bouri ne detyren e administratoreve te shoqerise "United Quarries" Sh.p.k.

\* \* \*

*Pika e II e rendit te dites:*


2. Te ndryshme

Nuk ka.

Meqenese te gjitha pikat e rendit te dites u diskutuan, dhe meqenese nuk ka gjera te tjera per t'u diskutuar, Drejtuesi deklaroi diskutimet te perfunduara dhe Mbledhjen e Ortakeve te mbyllur ne oren 11.30.

**Drejtuesi**


Serj Hreich



Serj Hreich

**Sekretari**

Joseph Abi Khalil



Joseph Abi Khalil

**NOTERE**  
Mimoza Shehu



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE

No. 3192 Rep.

No. 449 Kol.

13

VENDIM

Nr. 3, date 21.05.2010

**ASAMBLESE SE PERGIJTHSHME**  
**TE ORTAKEVE TE SHOQERISE**  
**"UNITED QUARRIES" Shpk.**



Sot ditën e Premte, 21 Maj 2010, Asambleja e Përgjithshme e Ortave të Shoqërisë "United Quarries" SHPK e thirrur dhe mbledhur rregullisht, pasi shqyrtoi rendin e dështimit:

1. Shkarkimi i Z. Sadi Dahdale nga detyra e administratorit të Shoqërisë;
2. Miratimi i Statutit të ndryshuar të Shoqërisë;
3. Te ndryshme.

Me unanimitet votash të ortave të pranishëm

Vendosi:

1. Shkarkohet Z. Sadi Dahdale nga detyra e administratorit të Shoqërisë.
2. Miratohet statuti i ndryshuar i Shoqërisë sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim pasi lexohet dhe shihet i formuluar sakte nënkërkëhet në prani të Noterit si me poshtë.

Drejtuuesi i Asamblese

Z. Edward Samaha

  
EDWARD SAMAHA


Mbajtësi i procesverbalit

Z. Maurice Bouri



NOTERI

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 1751 Rep.

Nr. 233 Kol. 15

VENDIM

I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE  
"UNITED QUARRIES" SHPK

Sot, ditën e Premte, në datën 12 të muajit Mars të vitit 2010 (dymijë e dhjetë), Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë United Quarries SHPK (me poshtë quajtur "Shoqëria") e mbledhur rregullisht në orën 10.00, në selinë e Shoqërisë në adresën Rr. Abdyl Frashëri, Pall. 11/1, Kati 7, pasi shqyrtoi rendin e dësuar si më poshtë:

1. Marrje e një huaje nga Raiffeisen Bank deri në shumën kufi 1.000.000 (një milion) Euro;
2. Aprovimi i vendosjes së hipotekës mbi token në pronësi të Shoqërisë si garanci për përmbushjen e detyrimit në favor të Raiffeisen Bank për një shumë huaje limit deri në 3.910.000 (tremilion e nentëqind e dhjetëmijë) Euro;
3. Miratimi i Statutit të Shoqërisë të përshtatur me ligjin e ri nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
4. Autorizimin e administratorëve të Shoqërisë për nënshkrimin e kontratave respektive të marrjes së huasë deri në 1.000.000 (një milion) Euro nga Raiffeisen Bank dhe vendosjes së hipotekës mbi token në pronësi të Shoqërisë si garanci në favor të Raiffeisen Bank për përmbushjen e detyrimit të Shoqërisë dhe për një shumë limit deri në 3.910.000 (tremilion e nentëqind e dhjetëmijë) Euro, dhe statutit të Shoqërisë.

Me shumicë

VENDOSI:

1. Miratimin e marrjes së një huaje nga Raiffeisen Bank deri në shumën kufi 1.000.000 (një milion) Euro.
2. Miratimin e vendosjes së hipotekës mbi pasuritë e paluajtshme të Shoqërisë si garanci në favor të Raiffeisen Bank për të garantuar përmbushjen e detyrimit



te riparimit te huase per nje shume limit deri ne 3.910.000 Euro (tremilione e nenteqindedhjetemije) ne total, e cila perfshin detyrimin e Shoqerise dhe te dy shoqerive te tjera: Elbasan Cement Factory SHPK, me Nr. Regjistrimi J82816206V dhe Seament Albania SHPK, me Nr. Regjistrimi J61827093K, strukturuar si vijon:

5. 1.000.000 EURO (nje milion), shume e cila garantohet nga pasuria e United Quarries SHPK me miratimin e kesaj shoqerise, si detyrim qe lind per United Quarries SHPK nga Raiffeisen Bank;
6. 1.670.000 EURO (nje milion e gjashteqind e shtatedhete mije), shume e cila garantohet nga pasuria e United Quarries SHPK me miratimin e kesaj shoqerise, si detyrim ekzistues i Elbasan Cement Factory SHPK ndaj Raiffeisen Bank;
7. 1.240.000 EURO (nje milion dyqind e dyzete mije), shume e cila garantohet nga pasuria e United Quarries SHPK me miratimin e kesaj shoqerise, si detyrim ekzistues i Seament Albania SHPK ndaj Raiffeisen Bank.

Pasurite e paluajtshme te Shoqerise mbi te cilat vendoset hipoteke ne favor te Raiffeisen Bank per shumen kufi deri ne 3.910.000 EURO (tremilion e nenteqind e dhjetemije) jane:

8. Pasuri e emertuar Zone Administrative, e regjistruar ne Regjistrin Hipotekor me nr. 40-390, me siperfaqe trualli 7963 m2, nga e cila 1420 m2 eshte ndertese, e ndodhur ne adresen: Letan, rrethi Elbasan;
  9. Pasuri e emertuar Depo Dinamiti, e regjistruar ne Regjistrin Hipotekor me nr. 40-391, me siperfaqe 180 m2, e ndodhur ne adresen: Letan, rrethi Elbasan;
  10. Pasuri e emertuar Zone Industriale, e regjistruar ne Regjistrin Hipotekor me nr. 40-392, me siperfaqe trualli 17.000 m2, e ndodhur ne adresen: Letan, rrethi Elbasan;
  11. Pasuri e emertuar Teleferiku, e regjistruar ne Regjistrin Hipotekor me nr. 40-393, me siperfaqe toke 1657,5 m2 dhe siperfaqe mbulimi 2962 m2."
3. Miratimin e Statutit te Shoqerise te pershtatur me ligjin e ri nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", sipas tekstit bashkelidhur.
  4. Autorizimin e administratoreve te Shoqerise per nenshkrimin e kontratave respektive, te marrjes se huase deri ne 1.000.000 (nje milion) Euro nga




Raiffeisen Bank dhe vendosjes se hipotekes mbi pasurine e paluajtshme ne pronesi te Shoqerise per te garantuar permbushjen e detyrimit ndaj Raiffeisen Bank per nje shume hua limit deri ne 3.910.000 (tremilion e nenteqind e dhjetemije) Euro, si dhe per nenshkrimin e statutit te Shoqerise.

Ky vendim eshte hartuar ne 6 (gjashte) kopje dhe pasi lexohet e perkthehet nga shqipja ne anglisht dhe shihet i formuluar sakte nenshkruhet ne prani te Noterit nga Kryetari dhe Mbajtesi i Procesverbalit te Asamblese se Pergjithshme te shoqerise United Quarries SHPK.

Kryetari



Mbajtesi i Procesverbalit



Perkthyesi



NOTERI



STATUTI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
UNITED QUARRIES SHPK

TITULLI I  
EMRI I SHOQERISE-ZYRA QENDRORE-KOHEZGJATJA

Neni 1

Emri

- 1.1 Shoqeria United Quarries SHPK (me poshte quajtur "Shoqeria") eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar dhe organizuar ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise.
- 1.2 Shoqeria ka vulen e saj zyrtare dhe logon.

Neni 2

Zyra qendrore

- 2.1 Zyra qendrore e Shoqerise eshte ne adresen: Rruga Abdyl Frasheri, Pallati 11/1, Kati i 7, Tirane, Shqiperi.
- 2.2 Shoqeria mund te hape ose te mbylle filiale, dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashte Shqiperise.

Neni 3

Kohezgjatja

- 3.1 Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise eshte per nje periudhe kohe te pakufizuar.

TITULLI II

OBJEKTI

Neni 4

Objekti

- 4.1 Objekti i Shoqerise perfshin, por pa u kufizuar vetem ne to, aktivitetet e meposhtme:



- a) Prodhimin dhe perpunimin e gurit gelqeror te fraksionuar;
  - b) Tregtimin, shitjen me shumice dhe pakice te gurit gelqeror;
  - c) Importimin e lendeve te para dhe materialeve e mallrave ndihmese per nevojat e prodhimit dhe realizimit te objektit te Shoqerise;
  - d) Eksportimin e prodhimeve te saj;
  - e) Transportin e mallrave e materialeve per nevojat e veta te Shoqerise;
  - f) Perdorimin e lendeve plasese per realizimin e objektit te veprimtarise.
- 4.2 Shoqeria do te kryeje çdo biznes te pershtatshem per realizimin e objektit te saj brenda kufirit te dispozitave ligjore.
- 4.3 Shoqeria mund te marre dhe te perfitoje hua dhe kredi nga institucione financiare shqiptare, te huaja dhe nderkombetare, si dhe te jape garanci e te krijojë a vendose privilegje, hipoteka, pengje dhe barre siguroese ne favor te ketyre institucioneve shqiptare, te huaja apo nderkombetare, per te siguruar permbushjen e detyrimeve te shoqerise, degëve dhe filialeve, apo shoqerive te treta te lidhura me te.
- 4.4 Shoqeria, gjithashtu, mund te kryeje çdo aktivitet tjeter tregtar i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji i zbatueshem.

### TITULLI III KAPITALI – KUOTAT – TRANSFERIMI I KUOTAVE

#### Neni 5 Kapitali

- 5.1 Kapitali i Shoqerise i nenshkruar dhe i shlyer plotesisht eshte 160.000.000 Leke (njeqind e gjashtedhete milion), i ndare ne 160.000 kuota (njeqind e gjashtedhete mije) me vlere nominale 1.000 Leke (njemije) secila. Kapitali zoterohet nga ortakët si me poshte:
1. Seament Albania SHPK, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me Nr. Regjistrimi J61827093K, date 23.09.1994, me zyre qendrore ne adresen: Rruga Abdyl Frasherit, Pallati 11/1, Kati 7, Tirane, Shqiperi, zoteron 137.600 kuota, me vlere nominale 137.600.000 Leke, qe perfaqesojne 86 % te kapitalit te Shoqerise;



2. Shteti Shqiptar, zoteron 20.950 kuota, me vlere nominale 20.950.000 Leke, qe perfaqesojne 13.094 % te kapitalit te Shoqerise;
3. Aishe Xhemal Kullolli, lindur ne Rile - Elbasan, me 14.07.1926, banuese ne Letan - Elbasan, zoteron 24 kuota, me vlere 24.000 Leke, qe perfaqesojne 0.015 % te kapitalit te Shoqerise;
4. Demir Sali Kullolli, lindur ne Letan - Elbasan, me 24.04.1954, banues ne Letan - Elbasan, zoteron 25 kuota, me vlere 25.000 Leke, qe perfaqesojne 0.016 % te kapitalit te Shoqerise;
5. Demir Ismail Gjoni, lindur ne Balez - Elbasan, me 07.03.1932, banues ne Balez Elbasan, zoteron 336 kuota, me vlere 336.000 Leke, qe perfaqesojne 0.210 % te kapitalit te Shoqerise;
6. Hamide Sali Kullolli, lindur ne Letan - Elbasan, me 11.05.1968, banuese ne Shirgjan - Elbasan, zoteron 25 kuota, me vlere 25.000 Leke, qe perfaqesojne 0.016 % te kapitalit te Shoqerise;
7. Hanife Demir Kullolli, lindur ne Letan - Elbasan, me 12.06.1908, banuese ne Rile- Elbasan, zoteron 147 kuota, me vlere 147.000 Leke, qe perfaqesojne 0.092 % te kapitalit te Shoqerise;
8. Hedije Sadik Kaçuli, lindur ne Balez - Elbasan, me 02.06.1948, banuese ne Balez - Elbasan, zoteron 336 kuota, me vlere 336.000 Leke, qe perfaqesojne 0.210 % te kapitalit te Shoqerise;
9. Hysen Isamil Gjoni, lindur ne Balez- Elbasan, me 01.01.1936, banuese ne Balez- Elbasan, zoteron 336 kuota, me vlere 336.000 Leke, qe perfaqesojne 0.210 % te kapitalit te Shoqerise;
10. Islam Sali Kullolli, lindur ne Letan - Elbasan, me 11.04.1962, banues ne Letan - Elbasan, zoteron 25 kuota, me vlere 25.000 Leke, qe perfaqesojne 0.016 % te kapitalit te Shoqerise;
11. Isuf Sali Kullolli, lindur ne Letan - Elbasan, me 16.09.1951, banues ne Letan - Elbasan, zoteron 24 kuota, me vlere 24.000 Leke, qe perfaqesojne 0.015 % te kapitalit te Shoqerise;
12. Qemal Kamber Kullolli, lindur ne Letan - Elbasan, me 28.10.1963, banues ne Leta n- Elbasan, zoteron 37 kuota, me vlere 37.000 Leke, qe perfaqesojne 0.023 % te kapitalit te Shoqerise;
13. Sanije Ismail Kullolli, lindur ne Cernje - Elbasan, me 28.10.1928, banues ne Letan - Elbasan, zoteron 36 kuota, me vlere 36.000 Leke, qe perfaqesojne 0.023 % te kapitalit te Shoqerise;



14. Shefikat Kamber Kullolli, lindur ne Letan - Elbasan, me 17.07.1955, banuese ne Rile - Elbasan, zoteron 37 kuota, me vlere 37.000 Leke, qe perfaqesojne 0.023 % te kapitalit te Shoqerise;
15. Xhemile Kamber Kullolli, lindur ne Letan - Elbasan, me 16.05.1953, banuese ne Rile - Elbasan, zoteron 37 kuota, me vlere 37.000 Leke, qe perfaqesojne 0.023 % te kapitalit te Shoqerise;
16. Zegjine Sali Kullolli, lindur ne Letan - Elbasan, ne date 05.10.1957 banuese ne Letan - Elbasan, zoteron 25 kuota, me vlere 25.000 Leke, te cilat perfaqesojne 0.016% te kapitalit te Shoqerise.
- 5.2 Ortaket kane te drejte te marrin pjese ne shperndarjen e fitimit te Shoqerise ne raport me pjesmarrijen ne kapitalin e Shoqerise.
- 5.3 Ortaket nuk pergjigjen per detyrimet e Shoqerise dhe mbulojne personalisht humbjet e saj deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara.

#### Neni 6

##### Zmadhimi i kapitalit

- 6.1 Zmadhimi i kapitalit behet me vendim te Asamblese se Pergjithshme sipas nenit 13 te ketij statuti.
- 6.2 Zmadhimi i kapitalit mund te behet me derdhje ne para ose me kontribute ne natyre. Keto kontribute duhet te nenshkruhen dhe, sipas vendimit te Asamblese se Pergjithshme, te shoqerohen me nje certifikate per depozitimin e tyre ose nje raport vleresimi teknik te kryer nga nje ekspert i vleresimit te kontributeve ne natyre.

#### Neni 7

##### Zvogelimi i kapitalit

- 7.1 Zvogelimi i kapitalit behet me vendim te Asamblese se Pergjithshme me propozim te administratorit/eve vetem ne rastin kur Shoqeria mund te pesoje humbje te tilla qe ta bejne te domosdoshme kete zvogelim.
- 7.2 Asambleja e Pergjithshme per zvogelimin e kapitalit vendos me shumicen e percaktuar ne nenin 13 te ketij statuti.



Neni 8  
Transferimi i kuotave

- 8.1 Kuotat e kapitalit te Shoqerise dhe te drejtat e detyrimet qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:
- a) kontributit ne kapitalin e Shoqerise;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashegimise;
  - d) dhurimit;
  - e) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.
- 8.2 Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.
- 8.3 Kuotat jane lirisht te transferueshme midis ortakeve te Shoqerise.
- 8.4 Ortaket e Shoqerise kane te drejten e parablerjes se kuotave.

Neni 9  
Transferimi tek personat e trete

- 9.1 Personat e trete jashte Shoqerise mund te behen zoterues te kuotave vetem pas miratimit te Asamblese se Pergjithshme, miratim i cili nuk mund te mos jepet pa arsye.
- 9.2 Projekti i transferimit i njoftohet secilit prej ortakeve. Brenda 3 (tre) muajve nga data e njoftimit te ketij projekti, Asambleja e Pergjithshme duhet te beje te ditur vendimin e saj, ne rast te kundert miratimi i transferimit konsiderohet i dhene.
- 9.3 Nese Asambleja e Pergjithshme nuk do te pranoje projektin dhe nuk do te miratoje transferimin, atehere ortaket jane te detyruar qe brenda nje periudhe prej 1 (nje) muaji nga data e vendimit te Asamblese se Pergjithshme qe ka vendosur mosmiratimin e transferimit, te blejne ose te lejojne blerjen e kuotave.

TITULLI IV  
ORGANET E SHOQERISE

Neni 10  
Organet e Shoqerise

- 10.1 Organet e Shoqerise jane:



- 1) Asambleja e Pergjithshme;
- 2) Administratori/et

TITULLI V  
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Neni 11  
Thirrja

- 11.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimarrës i Shoqerise dhe i merr vendimet kur eshte njoftuar dhe mbajtur rregullisht.
- 11.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme, e thirrur dhe e mbajtur rregullisht, ne perputhje me ligjin dhe me kete statut jane te detyrueshme per te gjithë ortaket duke perfshire edhe ata qe mungojne ose jane te perfaqesuar.
- 11.3 Asambleja e Pergjithshme mbahet ne rastet e parashikuara nga dispozitat e ketij statuti, ne rastet e parshikuara ne ligjin per tregtaret dhe shoqerite tregtare, ne ligje te tjera si dhe sa here eshte e nevojshme per mbrojtjen e interesave te Shoqerise.
- 11.4 Asambleja e Pergjithshme mbahet ne zyren qendrore te Shoqerise ose ne çdo vend tjetër te shenuar ne njoftimin per thirrjen e saj. Njoftimi i Asamblese se Pergjithshme behet me shkrese, por mund te behet edhe nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e Asamblese dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 (shtate) dite përpara dates se parashikuar per mbajtjen e Asamblese.
- 11.5 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nga administratoret. Thirrja e Asamblese se Pergjithshme mund te kerkohet edhe nga ortaku ose ortaket qe perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne Asamblene e Pergjithshme. Kerkesa duhet te permbaje arsyet, objektivat dhe çeshtjet per te cilat asambleja duhet te marre nje vendim.
- 11.6 Asambleja e Pergjithshme thirret ne mbledhje te zakonshme dhe te jashtezakonshme.



Neni 12  
Asambleja e Zakonshme

- 12.1 Asambleja e Zakonshme mbledhet, çdo vit brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit financiar, për miratimin e raportit të administratoreve, inventareve dhe llogarive vjetore.
- 12.2 Vendimet merren me shumicë të zakonshme të votave në prani të ortakeve me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 30 % të kuotave.
- 12.3 Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikës 12.2, asambleja do të mbahet perseri jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë më tej në të njëjtin rend dite.

Neni 13  
Asambleja e Jashtëzakonshme

- 13.1 Asambleja e Jashtëzakonshme thirret sa here është e nevojshme për marrjen e vendimeve në interes të Shoqërisë.
- 13.2 Vendimet që kanë të bëjnë me miratimin e ortakeve të rinj, me ndryshimin e nënëve të statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, prishjen e Shoqërisë, pa u kufizuar vetëm në to, konsiderohen vendime të jashtëzakonshme.
- 13.3 Vendimet e jashtëzakonshme merren nga Asambleja e Përgjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm, votojnë me shkrese ose mjete elektronike.
- 13.4 Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikës 13.3, asambleja mbledhet perseri jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë më tej në të njëjtin rend dite.

Neni 14  
Pjesëmarrja, Votimi dhe Perfaqësimi në Asamblenë e Përgjithshme

- 14.1 Secili ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe votimit në Asamblenë e Përgjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak janë në numër të barabartë me kuotat e zotëruara prej tij.





- 14.2 Secili ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjet e Asamblese dhe marrjen e vendimeve nga nje ortak tjetër apo nga nje person i tretë. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.
- 14.3 Ortaket persona juridike perfaqesohen ne mbledhjet e Asamblese vetem nga perfaqesuesit e tyre ligjore ose çdo person tjetër i pajisur me prokure te posaçme te leshuar nga organi kompetent i personit juridik.

#### Neni 15

##### Procesverbali i mbledhjes

- 15.1 Ne çdo mbledhje te Asamblese mbahet procesverbal i cili permban daten, vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetarit e te mbajtesit te procesverbalit, rezultatet e votimit si dhe vendimet.
- 15.2 Procesverbali nenshkruhet nga kryetari dhe mbajtesi i procesverbalit.

#### Neni 16

##### Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme

- 16.1 Asambleja e Pergjithshme eshte kompetente per te vendosur per çeshtjet e meposhtme:
- (a) percaktimin e politikave tregtare te Shoqerise;
  - (b) ndryshimin e statutit;
  - (c) emerimin dhe shkarkimin e administratorit/eve dhe vendos per shperblimin e tij/tyre;
  - (d) emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar dhe vendos per shperblimin e tyre;
  - (e) mbikyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - (f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimtarise;
  - (g) miratimin e zmadhimit dhe zvogelimit te kapitalit;
  - (h) pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre;



- (i) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/eve;
- (j) shperndarjen e fitimeve;
- (k) riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- (l) miratimin e rregullave proceduriale te mbajtjes se asamblese;
- (m) çeshtje tjeter te caktuar nga ligji ose nga ky statut.

TITULLI VI  
ADMINISTRATORET

Neni 17  
Administratoret

- 17.1 Shoqeria administrohet nga nje ose me shume administratore, persona fizike te zgjedhur brenda ose jashte bashkesise se ortakeve, te cilet emerohen nga Asambleja e Pergjithshme sipas nenit 12 te ketij statuti.
- 17.2 Veprimet e administrimit te Shoqerise do te konsiderohen te vlefshme nese jane ndermarre dhe nenshkruar nga dy prej administratoreve te Shoqerise.
- 17.3 Administratoret emerohen per nje periudhe 5 (pese) vjeçare dhe mund te ri emerohen.
- 17.4 Administratoret e Shoqerise jane:
  - 1. Z. Alexandre Fotios Bouri, shtetas grek, lindur me 04.09.1936, ne Antaki, mbajtes i pasaportes nr. RL1666938
  - 2. Z. Maurice Bouri, shtetas britanik, lindur me 31.08.1978, ne Londer, mbajtes i pasaportes nr.801112185
  - 3. Z. Sadi Dahdale, shtetas grek, lindur me 04.05.1964, ne Beirut, mbajtes i pasaportes nr. AB0822606;
  - 4. Z. Mark Alexander Bouri, shtetas Britanik, lindur me 21.10.1969, ne Londer, mbajtes i pasaportes nr. 761073102;
  - 5. Z. Edward Samaha, shtetas Amerikan, lindur me 28.05.1971, ne Tennessee SHBA, mbajtes i pasaportes nr. 452719744.
- 17.5 Administratoret shkarkohen nga detyra, ne çdo kohe, me vendim te zakonshem te Asamblese se Pergjithshme sipas nenit 12 te ketij statuti.



## Neni 18

### Kompetencat e Administratoreve

- 18.1 Administratoret janë përgjegjës për çështjet e përditshme të aktivitetit të Shoqërisë dhe përfaqësojnë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët në përputhje me dispozitat e statutit dhe ligjit të zbatueshëm.
- 18.2 Administratoret kanë të gjitha kompetencat e zakonshme dhe të jashtëzakonshme për administrimin e Shoqërisë, përveç atyre që sipas statutit ose ligjit të zbatueshëm i takojnë Asamblesë së Përgjithshme.
- 18.3 Administratoret kanë kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:
- (a) mbikqyrin dhe zbatojnë politikën e biznesit të Shoqërisë;
  - (b) përfaqësojnë Shoqërinë;
  - (c) kujdesen që Shoqëria zbaton ligjet dhe standartet e mbajtjes së llogarive;
  - (d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve ja paraqesin Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
  - (e) sigurojnë që deklaratat e llogarive vjetore si dhe raporti i ecurisë së biznesit dhe çdo deklaram tjetër të detyrueshme sipas ligjit ose statutit janë bërë siç duhet;
  - (f) sigurojnë që auditimi i librave dhe i të dhënave kryhet të paktën një herë në vit nga ekspertë kontabel të autorizuar dhe raporti i ekspertëve kontabel të autorizuar t'i vihet në dispozicion Asamblesë së Përgjithshme;
  - (g) raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme lidhur me zbatimin e politikave tregtare;
  - (h) kryejnë çdo detyrë tjetër të caktuar nga ligji ose statuti.

## TITULLI VII

### EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

## Neni 19

### Eksperti Kontabel i Autorizuar

- 19.1 Eksperti kontabel i autorizuar emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 12 të këtij statuti.



TITULLI VIII  
VITI FINANCIAR, FITIMET

Neni 20  
Viti Financiar

- 20.1 Viti financiar fillon me 1 Janar e perfundon me 31 Dhjetor te çdo viti.

TITULLI IX  
PRISHJA E SHOQERISE

Neni 21  
Prishja

- 21.1 Prishja e Shoqerise dhe emerimi i likuidatoreve behet ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

TITULLI X  
DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 22  
Baza ligjore

- 22.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe me ligjin shqiptar.
- 22.2 Per sa nuk parashikohet ne kete statut do te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fushen e shoqerive tregtare.
- 22.3 Çdo konflikt qe mund te linde ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij statuti si dhe çdo konflikt qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve do te zgjidhet me vendim te Gjykatave Shqiptare.




Neni 23  
Ndryshimet


23.1 Ky Statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Nenshkruar ne Tirane sot me date 12.03.2010.

Ortaket:

Perfaqesuesit e autorizuar  
sipas Vendimit te Asamblese se Pergjithshme  
date 12.03.2010:

  
Z. Edward Samaha

  
Z. Charles Michael Bouri

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
Nr. 6814 Rep.  
Nr. 3116 Kol.



**VENDIM**  
Nr. 1, date 09.10.2015

**ASAMBLESE TE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE TE SHOQERISE**  
**"UNITED QUARRIES" Shpk.**

Sot, ditën e Premte, në datën 09 të muajt Tetor të vitit 2015 (dymijë e pesëmbëdhjetë), në orën 11:00, në prezencë të noteres **Mimoza R. Shehu**, në selinë e ortakut mazhoritar shoqërisë "Seament Albania" shpk me adresë "Rr"Abdyl Farsheri" nr. 11/1, EGT Tower, Kati i 8-te, Tirane, u mbajt Asambleja e Ortakeve sipas njoftimit të bere nga ortakut mazhoritar, me qëllim që të shqyrtohet rendi i dities si më poshtë:

1. Mbi procedurën e privatizimit të kuotave shtetërore të shoqërisë "United Quarries" shpk sipas kërkesës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes.
2. Miratimi i ekspertës për vlerësimin e kuotave shtetërore të shoqërisë "United Quarries" shpk.
3. Ndryshime në Statutin e Shoqërisë "United Quarries" shpk.
4. Negocimin e shitjes së Frontos dhe të teleferikut nga shoqëria "United Quarries" për shoqërinë "Elbasan Cement Factory" shpk, duke përfshirë tokat përreth ku janë të vendosura pajisjet.
5. Miratimi i llogarive vjetore dhe pasqyrave financiare të Shoqërisë për vitin financiar 2014, i raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar të Shoqërisë për vitin financiar 2014 dhe i raportit mbi administrimin e Shoqërisë për vitin 2014 të përgatitur nga Administratorët;
6. Mbartjen e humbjes në bilancin e kompanisë për vitet e ardhshme.
7. Diskutimi dhe marrja e vendimit në lidhje me emërimin/rikonfirmimin e ekspertëve kontabël të Shoqërisë për vitin financiar 2015;
8. Miratimi i garancive për huatë të shoqërive "Seament Albania" shpk dhe "Elbasan Cement Factory" shpk.
9. Të ndryshme

**ME UNANIMITET VOTASH  
VENDOSI**

***1. Pranimin dhe miratimin e fillimit të Procedurave të Privatizimit të Kuotave shtetërore të shoqërisë "United Quarries" shpk***

***2. Shtyhet shqyrtimi i kësaj pike të rendit të dities dhe ortakët do të shprehen në mbledhjen vijuese të rradhes mbas 2 javësh.***

**ME SHUMICE VOTASH  
VENDOSI**



3. Miratimin e largimit nga shoqëria e admininstratoreve Z.Alexandre Bouri, Z.Mark Bouri, Z.Maurice Bouri dhe Z. Edward Samaha dhe ndryshimin e pikes 18.2 ne Statutin e Shoqërise "Elbasan Cement Factory" shpk e cila do te behet si vijon: : "Veprimet e ndermarra nga Shoqëria do te quhen te vlefshme me vlefshkrimin e administratorit te vetem shpk.

ME UNANIMITET VOTASH  
VENDOSI

4. Miratimin e Negocimit te shitjes së Frontos dhe të teleferikut nga shoqëria "United Quarries" shpk, " per shoqërine "Elbasan Cement Factory" shpk, duke përfshirë tokat përreth ku janë të vendosura pajisjet.

ME UNANIMITET VOTASH  
VENDOSI

5. Miratimin e llogarive vjetore dhe pasqyrave financiare te Shoqërise per vitin financiar 2014 dhe raportin e eksperteve kontabel te autorizuar të Shoqërisë për vitin financiar 2014

6. Miratohet mbartja e humbjes ne bilancin e vitit 2015

7. Emerimin e shoqërise " MAZARS" SHPK si ekspert kontabel per shoqërine " United Quarries" shpk per vitin financiar 2015

ME SHUMICE VOTASH  
VENDOSI

8 "Rinovimi i vendosjes ne rang te metejshem te barres ne favor te Raiffeisen Bank mbi tokat dhe ndertesat e shoqërise United Quarries shpk per te siguruar linjat e kredive te marra nenga Raiffeisen Bank nga shoqërite "Seament Albania" shpk dhe "Elbasan Cement Factory" shpk.

Mbledhja e Asamblese te Ortakeve ditën e Premte ne datën 09.10.2015 ora 11:55, konsiderohet e mbyllur.

1. Shteti Shqiptar perfq. Nga


Z. Alban Beqaj 

2. "Seament Albania" shpk Perfq. Nga


Z. Jorge Jeha 

Z. Charles Michael Bouri 

Mbajtësi i Proçesverbalit/Sekretar



Noteri

  
2/2

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE DURRES  
NR. 3719 REP.  
NR. 1909 KOL.



**VENDIM**

Nr. \_\_\_\_, date 07.09.2018

**IASAMBLESE TE PERGIITHSHME TE ORTAKEVE TE SHOQERISE**  
**"UNITED QUARRIES" Shpk.**

Sot, ditën e Premte, në datën 07 të muajit Shtator të vitit 2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), në orën 11:00, në prezencë të noterit Juled A. Beqiraj, në adresën Hotel "Univers" Elbasan, u mbajt Asambleja e Ortakeve sipas njoftimit të bërë nga ortaku mazhoritar, me qëllim që të shqyrtohet rendi i dities si më poshtë:

1. Miratimi i llogarive vjetore dhe pasqyrave financiare të Shoqërisë për vitin financiar 2017, i raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar të Shoqërisë për vitin financiar 2017 dhe i raportit mbi administrimin e Shoqërisë për vitin 2017 të përgatitur nga Administratorët;
2. Mbartjen e humbjes në bilancin e kompanisë për vitet e ardhshme.
3. Diskutimi dhe marrja e vendimit në lidhje me emërimin/rikonfirmimin e ekspertëve kontabël të Shoqërisë për vitin financiar 2018;
4. Miratimi i garancive për huane të shoqërisë "Elbasan Cement Factory" shpk.
5. Thirrja e ekspertëve të emeruar në mbledhjen paraardhëse dhe rishikimi i detyrave të lena mbi procedurën e privatizimit propozuar nga aksioneri shtet.
6. Ndryshime në Statutin e Shoqërisë.
7. Riemërimi i administratorit të shoqërisë "United Quarries" Shpk, Z. Charles Michael Bouri, për një afat kohor 5 vjeçar duke filluar nga data 30.05.2018 deri me datë 30.05.2023.
8. Të ndryshme

**ME UNANIMITET VOTASH**  
**VENDOSI**

**1. Miratimi i llogarive vjetore dhe pasqyrave financiare të Shoqërisë për vitin financiar 2017, i raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar të Shoqërisë për vitin financiar 2017 dhe i raportit mbi administrimin e Shoqërisë për vitin 2017 të përgatitur nga Administratorët;**

**2. "Humbja neto mbas taksave gjatë vitit financiar 2017 në vlerën 31.343.197 Leke do të mbartet në pasqyrat e bilancit për vitet e ardhshme."**

**3. Caktimi i mandatit të Shoqërisë "MAZARS" si ekspert kontabel të Shoqërisë për vitin financiar 2018."**

**4. Rinovimi i vendosjes në rang të parë të barres në favor të Raiffeisen Bank mbi tokat dhe ndërtesat e shoqërisë United Quarries shpk për të siguruar linjat e kredive të marra nga Raiffeisen Bank.**

**5. Për pikën pesë të rendit të dities Ortaku mazhoritar nuk merr vendim.**

**6. Ndryshon Neni 2 i Statutit "Zyra Qendrore" dhe behet: Zyra e Shoqërisë është në adresën Elbasan, Balez, Fabrika e Cimentos, zona kadastrale 1079, nr. Pasurie 323.**



7. Riemerimin e administratorit te shoqerise "United Quarries" Shpk, Z. Charles Michael Bouri, per nje afat kohor 5 vjecar duke filluar nga data 30.05.2018 deri me date 30.05.2023.


8.-Miratohet cmontimi i teleferikut nga ambjentet e shoqerise United Quarries deri tek Kurumi.

\* \* \*


Mbledhja e Asamblese te Ortakeve ditën e Premte ne datën 07.09.2018 ora 11:30, konsiderohet e mbyllur.

Shoqeria "Seament Albania" shpk Perfq. nga

Z. Elton Bregu

Elton Bregu 

Znj. Lorida Jorgoni

Lorida Jorgoni 

Mbajtesi i Proces Verbalit dhe Sekretari

Znj. Adelajda Roka

Adelajda Roka 

NOTERI

